| DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT | SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS | POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU |
|---|---|---|

**AC-II-12-0122**

***Paditësi:***

Në padinë e

**M.P nga Obiliqi**

I përfaqësuar nga avokati B.J Prishtinë

**Kundër**

***E paditura /Ankuesja:***

**NSH' K"-E'**

E përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga "Ilir Konushevci", nr. 8, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Vladimir Kanev, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e AKP-së të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të datës 4 shkurt 2010 në lëndën c.n.1765/07 në seancën vendimmarrëse të mbajtur me 14 dhjetor 2016 lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

1. **Ankesa e AKP-së është e bazuar.**
2. **Anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 4 shkurt 2010 për lëndën c.n. 1765/07.**
3. **Padia refuzohet si e pabazuar**
4. **Ankesa e AKM-së hedhet poshtë si e papranueshme.**
5. **Nuk është caktuar asnjë taksë gjyqësore për procedurën ankimore.**

**<u>Rrethanat faktike dhe procedurale</u>**

Lënda për herë të parë ishte paraqitur në Gjykatën Komunale të Prishtinës me 27 tetor 2006. Me 18 prill 2007, Gjykata Komunale e Prishtinës e shpalli veten jo-kompetente. Rasti iu kishte referuar Gjykatës së njëjtë Komunale në Prishtinë nga DHPGJS me 2 korrik 2007.

Më 24 prill 2007, paditësi M.P ka paraqitur në Dhomën e Posaçme (DHPGJS) një padi për anulimin e kontratës dhe dorëzimin e pronës së paluajtshme. Me vendimin për lëndën SCC-07-0182, DHPGJS-ja referoi çështjen gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Me aktgjykimin në lëndën p. nr. 1765/07 të datës 4 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e miratoi padinë dhe e shpalli si të pavlefshme kontratën 147/78 në mes të M.P dhe NSH "K",-E". Objekt i kësaj kontrate ishte pronësia mbi 4.50,52 ha livadh në Zonën Kadastrale të Obiliqit, të cilën paditësi ia kishte transferuar paraardhësve të padituës "OTHPB "P" nëpërmjet kontratës së anuluar. Përveç kësaj gjykata ka vendosur që i padituës tek paditësi tri parcela të ndryshme nr. 685 me sipërfaqe 1.63,29 ha, ngastrën kadastra le nr. 686/1 me sipërfaqe 0.34, 02 ha dhe ngastrën nr. 688 me sipërfaqe 2.66,18 ha – me sipërfaqen e përgjithshme prej 4.63,49 ha. Parcelat që do të dorëzohen në mënyrë të konsiderueshme nuk janë identike me pasurinë e transferuar me kontratë, në këtë mënyrë, pra, këto janë dhënë në vend të pasurisë origjinale.

Shkalla e parë ka gjetur se paditësi, si pronar i ligjshëm i pronës i ishte nënshtruar ndikimit të padrejtë dhe vetëm për shkak të presionit ishte pajtuar që t'ia shesë pronën ish "OTHPB "B". Sipas arsyetimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, ndikimi i tepruar i bën kontratat e pavlefshme në pajtim me nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Duke pasur parasysh se pasuria origjinale është e vendosur në një zonë të konsolidimit të tokës dhe në këtë mënyrë nuk është "e përshtatshme" për t'u kthyer, gjykata ia ka lejuar paditësit kompensimin *in rem.*

Më 17 Mars 2010 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar brenda afatit të caktuar kohor ankesë kundër aktgjykimit në fjalë. Kundërshtimi kryesor i Agjencisë është se Gjykata Komunale në Prishtinë ka zbatuar në mënyrë të gabueshme nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve mbi një marrëveshje e cila ishte lidhur nën ndikim të tepruar. Në bazë të ankesës gjykata është dashur që të përfshijë faktet sipas nenit 111, i cili i konsideron kontratat e lidhura nën presion si të pavlefshme dhe në përputhje me nenin 117 të njëjtit ligj anulimi i kontratave të pavlefshme mund të kërkohet vetëm brenda një viti pas mbarimit të detyrimit.

Më 12 prill 2010, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit kishte paraqitur ankesë.

Avokati i paditësit kishte paraqitur përgjigje në ankesën e AKP-së me 26 prill 2010 dhe kishte kërkuar nga DHPGJS-të që të vërtetojë vendimin e shkallës së parë si të saktë dhe të vërtetuar.

**Arsyetimi Ligjor**

Në bazë të nenit 64 paragrafi 1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Ankesa e AKP-së është e bazuar. Ankesa e AKM-së është e papranueshme.

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 04 / L-034), sipas ligjit vetëm AKP-ja është kompetente për të përfaqësuar Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë. Prandaj, AKM-ja nuk ka interes juridik për të paraqitur ankesë.

Ankesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit është e bazuar. Kontratat e lidhura nën detyrim janë të rrëzueshme por jo të pavlefshme. Dispozita e veçantë e cila është e përshtatshme për t'u zbatuar është neni 111 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i lidhur me nenin 117 të njëjtit ligj. Prandaj – Prandaj, cilado që të jetë data pas vitit 1978 që mund të konsiderohet si moment i saktë kur ka pushuar detyrimi apo kërcënimet ndaj paditësit, afati njëvjeçar për parashtrimin e anulimit kishte skaduar. Për këtë arsye, në mënyrë të ligjshme nuk mund të lejohet anulimi në çështjen gjyqësore në fjalë.

Përveç kësaj, Gjykata Komunale e Prishtinës nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për të lejuar kompensimin *in rem* - kjo është kundër rregullit të përgjithshëm të kompensimit monetar për të gjitha llojet e dëmeve. Kthimi, duke ofruar pronë në vend të pronës, mund të bëhet vetëm me ligj të veçantë që ende nuk është miratuar nga ligjvënësi.

**Taksat Gjyqësore**

Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive për lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Apelit të DHPGJS, me 14 dhjetor 2016.

Mr.sc.Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____